

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE DHE DHËNIA E PËLQIMIT

Në mënyrë që të vijoni regjistrimin për marrjen e këtij produkti kërkohet që të plotësohen në formën e aplikimit online të dhënat personale si: emër, mbiemër, gjinia, shtetësia, datëlindje, numer telefoni fikse & celular, adresë banimi, adresë email-i, shteti, qyteti, emri i punëdhënesit, numer telefoni punëdhënesit, të ardhurat neto, të ardhura të tjera.

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Banka e konsideron mbrojtjen e privatësisë dhe të të dhënave tuaja personale si çështje shumë të rëndësishme dhe është e përkushtuar të zbatojë kuadrin ligjor në mbrojtje dhe respektim të tyre, ashtu siç edhe përcaktohet, në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili zëvendësohet me Ligjin nr.124/2024 datë 19.12.2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre, si dhe Rregulloren Europiane për Mbrojtjen e të Dhenave Personale.

Informacioni i detajuar për kategorinë e të dhënave që përpunohen, qëllimet, kriteret e përpunimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale gjenden në faqen e internetit të Bankës

<https://www.raiffeisen.al/alb/> menyuja “Mbrojtja e të dhënave personale” në linkun

<https://www.raiffeisen.al/alb/about/pages/mbrojtja-e-te-dhenave/>

Përdoruesi konfirmon plotësimin dhe vërtetësinë e informacionit të dhënë dhe deklaron gjithashtu se ka plotësuar në mënyrë korrekte dhe të vërtetë të tërë informacionin të kërkuar.

DHËNIE PËLQIMI

Me plotësimin e aplikimit online, përdoruesi deklaron se jep miratimin e tij për përpunimin e mëtejshëm të informacionit të dhënë prej tij nga Raiffeisen Bank, vetëm për qëllimin e përdorimit të produktit Karte Krediti për të cilin përdoruesi ka deklaruar vullnetarisht të dhënat e tij personale. Në çdo moment pasi përdoruesi të ketë dhënë vullnetarisht informacionin e kërkuar në këto fusha specifike, këtij të fundit i lind e drejta që, nëpërmjet një kërkesë pranë Raiffeisen Bank, të aksesojë këto të dhëna si dhe të kërkojë, bllokimin, korrigjimin apo fshirjen e tyre në përputhje me parashikimet e bera në Ligjin nr.9887 dt 10.03.2008 “për mbrojtjen e të dhënave Personale” dhe GDPR.

Nëse ju terhiqeni nga ky aplikim, para se të klikoni butonin “Apliko”, duke mos dashur të vijoni më tej me regjistrimin, në këtë rast të dhënat tuaja personale nuk ruhen nga Banka. Nëse pas regjistrimit vendosni të regjistroheni nga marrja e produktit, ju mund të dërgoni një kërkesë për ç’regjistrim në adresën info@raiffeisen.al. Pasi të ç’regjistroheni nga përdorimi i këtij shërbimi/produkti, të dhënat tuaja personale do të ruhen vetëm në kuader të marrëdhënies që keni si klient me Bankën. Për çdo ankese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, mund t’i drejtoheni “Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale”.